



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____, Prot.

Tiranë, më _____, _____, 2023

Lënda: Kthim përgjigje

Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, regjistruar me numër rendor 7, në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve, me aktet nr. 1420/2 Prot., datë 27.02.2023 dhe nr. 1420/3 Prot., datë 27.02.2023, referuar nenit 14§2§b të Ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, ju bëjmë me dije si më poshtë:

Në vijim të VKM-së nr. 495, datë 21.07.2022 “Për riorganizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencave gjyqësore të gjykatave”, Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor ka ngritur pranë institucionit të KLGJ-së, Grupin Ndërinstitucional të Punës, me anë të Urdhrit nr. 80, datë 28.07.2022.

Grupi Ndërinstitucional i Punës ka vijuar punën duke zhvilluar mbledhje, në të cilat janë dakortësuar Plani i Veprimit dhe afatet kohore për çdo veprim, duke synuar përmbushjen në kohë dhe me efektivitet të procesit të riorganizimit të kompetencave tokësore të gjykatave, sipas fazave përkatëse.

Shtyllat kryesore të punës përfshijnë burimet njerëzore, infrastrukturën dhe godinat, teknologjinë e informacionit, administrimin gjyqësor si dhe informimin e publikut. Më konkretisht mbi efektet në burimet njerëzore, Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbështetje të vendimit të saj, nr. 505, datë 21.11.2022 “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm” ka miratuar edhe vendimin nr. 555, datë 29.12.2022 “Për rishpërndarjen e numrit të pozicioneve të punës në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe në gjykatat e rretheve gjyqësore”, me anë të së cilit është vendosur rishpërndarja e numrit të pozicioneve të punës së gjykatat respektive. Aktualisht, për gjykatat e apelit Vlorë, Gjirokastrë, Shkodër, Korçë, Durrës dhe Tiranë ka përfunduar procesi i riorganizimit dhe të gjithë nëpunësit/punonjësit janë sistemuar në pozicione pune.

Lidhur me gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm po vijohet puna për draftimin e akteve dhe finalizimin e procesit të implementimit të Hartës së Re Gjyqësore, (faza II).

Për sa më sipër, ju bëjmë me dije se Harta e Re Gjyqësore nuk sjell pakësim të burimeve njerëzore, pavarësisht uljes së numrit të gjykatave. Kjo vjen për shkak se numri i çështjeve gjyqësore për gjykim nuk pakësohet, përkundrazi ato vijnë në rritje për çdo vit.

Lidhur me akomodimin e Gjykatës së Apelit me Juridiksion të Përgjithshëm është vlerësuar se në një zgjidhje afatgjatë nevojitet ndërtimi i një godine të re. Aktualisht stafi i gjykatës së riorganizuar është akomoduar në godinën ekzistuese të ish-Gjykatës së Apelit Tiranë, në kushtet kur numri i gjyqtarëve të apelit aktualisht në detyrë është më i vogël se numri i organikës së miratuar.

Gjithashtu ju informojmë se, në muajin qershor 2022, ish-Gjykatës së Apelit Tiranë, ju akordua një fond në vlerën 2,000,000 lekë, për të realizuar projektin për rikonstruksionin e pjesshëm të ambienteve të godinës ekzistues, projekt i cili kishte të bënte me përmirësimin e rrjetit kompjuterik dhe elektrik, si dhe rikonstruksionin e bodrumeve të godinës për t'u përshtatur si ambiente arkive. Ndërsa në muajin shtator 2022, kësaj gjykate i është akorduar një fond në shumën 23,800,000 lekë, për të bërë të mundur realizimin e punimeve të zbatimit sipas këtij projekti. Projekti i rikonstruksionit është përfunduar me sukses.

Ju faleminderit për mirëkuptimin!